



SHTEGU IM

PËR MBËSHTETJEN TE VETJË



UDHËZIME PËR NDËRMJETËSIN

Udhëzimet për ndërmjetësin e mbledhjes shpirtërore gjithmonë do të shfaqen në kutitë ngjyrë vjollcë. Për ndihmë shtesë në drejtimin e një mbledhjeje shpirtërore, shihni faqen 13.

SI TË PËRDORET KJO BROSHURË

Kjo broshurë hartohet që të përdoret në formatin e një mbledhjeje shpirtërore. Sidoqoftë, ajo mund të përdoret edhe në mjedise të tjera grupesh ose individësh, duke përfshirë:

- Mësimet e të dielave të pesta.
- Mbledhjet e kuorumeve ose të Shoqatës së Ndihmës.
- Në shtëpi.
- Mjedise të tjera të përshtatshme.

KUR JU I SHIHNI KËTO NXITJE, NDIQINI KËTO UDHËZIME				
LEXONI	SHIHNI	DISKUTONI	PËRSIATNI	VEPRIMTARI
Një person lexon me zë të lartë për të gjithë grupin.	I gjithë grupi shikon materialin filmik.	Si grup i vogël (2–8 veta), shprehni mendimet tuaja për 2–4 minuta.	Në mënyrë individuale përsiatni dhe shkruani në heshtje për afërsisht 2–3 minuta.	Punoni individualisht ose së bashku si një grup i vogël (2–8 veta) për kohën e përcaktuar.

Një mbledhje shpirtërore e programit Shtegu Im nuk duhet të zgjatë më shumë se 90 minuta.

Botuar nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Solt-Lejk-Siti, Juta

© 2016 nga Intellectual Reserve, Inc.

I rezervohen të gjitha të drejtat.

Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Miraturar për anglisht: 7/16

Miraturar për përkthim: 7/16

Përkthim i *My Path to Self-Reliance*

Albanian

14068 101

MESAZH NGA PRESIDENCA E PARË

Të Dashur Vëllezër dhe Motra:

Zoti ka shpallur: “Është qëllimi im për të siguruar për shenjtorët e mi” (DeB 104:15). Kjo zbulesë është një premtim nga Zoti se Ai do të sigurojë bekime materiale dhe do ta hapë derën e mbështetjes te vetja, e cila është aftësia jonë që t’i sigurojmë nevojat e jetës për veten dhe pjesëtarët e familjes sonë.

Kjo broshurë është përgatitur për t’i ndihmuar anëtarët e Kishës që t’i mësojnë dhe t’i vënë në zbatim parimet e besimit, arsimimit, të punuarit fort dhe mirëbesimit në Zot. Pranimi dhe të jetuarit e këtyre parimeve do t’jua bëjnë më të mundur që t’i merrni bekimet materiale të premtuara nga Zoti.

Ne ju ftojmë që t’i studioni me zell dhe t’i zbatoni këto parime, dhe t’ua jepni mësim pjesëtarëve të familjes suaj. Ndërsa bëni kështu, jeta juaj do të bekohet. Ju do të mësoni se si të veproni në shtegun tuaj drejt mbështetjes më të madhe te vetja. Ju do të bekoheni me shpresë, paqe dhe përparim më të madh.

Ju lutemi, jini i sigurt se ju jeni një fëmijë i Atit tonë në Qiell. Ai ju do dhe nuk do t’ju braktisë asnjëherë. Ai ju njeh dhe është gati t’ju shtrijë bekimet shpirtërore dhe materiale të mbështetjes te vetja.

Sinqerisht,

Presidenca e Parë

SHTEGU IM PËR MBËSHTETJEN TE VETJA

UDHËZIME TË FILLIMIT

- Ndërmjetësi:**
1. Filloni me një lutje (dhe himn, nëse dëshironi).
 2. Një anëtar i presidencës së kunjit mund të bëjë një prezantim dhe të japë një dëshmi për 3 deri 5 minuta.
 3. Një anëtar i komitetit të kunjit për mbështetjen te vetja e fton të gjithë grupin t'i hapin broshurat e tyre te faqja 2 dhe ta ndjekin teksa anëtari i komitetit lexon tre paragrafët më poshtë.

Mirë se vini në këtë mbledhje shpirtërore të programit Shtegu Im për Mbështetjen te Vetja. Qëllimi i kësaj mbledhjeje është t'ju ndihmojë të kuptoni arsyen përse dhe mënyrën se si mund të bëheni më të mbështetur te vetja. Në vend që një folës t'i bëjë paraqitje grupit, ne do të diskutojmë parime në grupe të vogla, do të lexojmë së bashku, do të përsiatim e shkruajmë mendimet tona.

Pjesa më e rëndësishme e kësaj përvoje do të jenë nxitjet që i merrni nëpërmjet Shpirtit teksa Zoti ju tregon atë që mund të bëni për t'u bërë më shumë si Ai. Ju nxitim t'i shkruani këto mbresa teksa i merrni ato dhe më pas të veproni sipas tyre.

Në fund të kësaj mbledhjeje ju do të ftoheni që të zgjidhni një grup të mbështetjes te vetja, që mund t'ju ndihmojë të arrini njërin prej synimeve vijuese:

- Të gjeni një vend pune ose ta përmirësoni punësimin tuaj të tanishëm
- T'i administroni më mirë financat tuaja vetjake dhe familjare
- Të zgjidhni një shteg të arsimit dhe t'ia dilni mbanë në shkollë
- Ta rritni biznesin tuaj të vogël

Por për tani, le të njihemi ca më mirë me njëri-tjetrin.

Ndërmjetësi : Kërkojuni pjesëmarrësve te secila tavolinë që për një çast t'ua prezantojnë shkurtimisht vetveten të tjerëve te tavolina e tyre. Çdo prezantim nuk duhet të zgjatë më shumë se 30 apo 40 sekonda.

ÇFARË ËSHTË MBËSHTETJA TE VETJA?

Lexoni: Synimi i nismës për mbështetjen te vetja është t'i ndihmojë individët që ta ndihmojnë veten e tyre për t'u bërë të mbështetur te vetja. Mbështetja te vetja është më shumë sesa të kesh një vend pune të mirë, rezervë ushqimesh ose para në bankë. Mbështetja tek vetja është **“aftësia, zotimi dhe përpjekja** për të siguruar **nevojat shpirtërore dhe materiale** të jetës për veten dhe familjen. Kur anëtarët bëhen të mbështetur te vetja, ata janë gjithashtu më të aftë që të **shërbejnë** e të kujdesen për të tjerët” dhe puna kurorëzohet si parim udhëheqës në jetën e tyre (*Manuali 2: Administrimi i Kishës* [2010], 6.1.1).

Diskutoni: Cilat janë karakteristikat e një individi të mbështetur te vetja? A do të mbështeteshin te ndihma e qeverisë ose Kishës individët e mbështetur te vetja nëse, në vend të kësaj, do të mund të punonin për atë që u nevojitej?

MBËSHTETJA TE VETJA ËSHTË THELBËSORE PËR SHPËTIMIN

Lexoni: Presidenti Tomas S. Monson dha mësim: “Le të jemi të mbështetur te vetja dhe të pavarur. Shpëtimi nuk mund të arrihet mbi asnjë parim tjetër” (“Guiding Principles of Personal and Family Welfare”, *Ensign*, shtator 1986, f. 3; duke cituar Marion G. Romney-n, në Conference Report, tetor 1976, f. 167).

Diskutoni: Kur bëheni më të mbështetur te vetja, si jeni duke u bërë të ngjashëm me Atin Qiellor?

SHPIRTËRORJA DHE MATERIALJA JANË NJË

VEPRIMTARI GRUPI (3-4 minuta)

Si grup, diskutoni disa domosdoshmëri materiale dhe shpirtërore të jetës. Rënditni disa më poshtë.

DOMOSDOSHMERITË MATERIALE TË JETËS	DOMOSDOSHMERITË SHPIRTËRORE TË JETËS

Lexoni: Presidenti Diter F. Uhtdorf dha mësim: “Njësoj si dy anët e një monedhe, [materialja] dhe shpirtërorja janë të pandashme” (“Ndihma sipas Mënyrës së Zotit”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2011, f. 53). Në shkrimet e shenjta Zoti shpalli: “Gjithë gjërat për mua janë shpirtërore dhe asnjëherë nuk ju kam dhënë një ligj që është tokësor” (DeB 29:34).

Diskutoni: Si mund të jenë një çështje si materiale ashtu edhe shpirtërore gjetja e një vendi pune dhe fitimi i jetesës?

SA I MBËSHTETUR TE VETJA JENI JU, MATERIALISHT DHE SHPIRTËRISHT?

VEPRIMTARI INDIVIDUALE (5 minuta)

Mbështetja te vetja kërkon **aftësi, zotim** dhe **përpjekje**. Në mënyrë të pavarur vendosni një shenjë përzgjedhëse në secilën kuti që gjen zbatimin më të mirë për ju. Jini të sinqertë me veten. Nëse nuk ndiheni rehat që t'i shenjoni këto me njerëz përreth, mbulojini përgjigjet tuaja.

	Kurrë	Rrallë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
Unë i kam aftësitë për të siguruar të ardhura për nevojat e mia.					
Unë kam një buxhet dhe eci sipas tij.					
Unë kursej para.					
Unë nuk kam borxhe (me përjashtim për arsimim ose një shtëpi).					
Jeta ime përqendrohet te gjërat që kanë më tepër rëndësi.					
Unë lutem dhe i studioj përditë shkrimet e shenjta.					
Unë ndiej nxitje të përditshme nga Shpirti në jetën time.					
Unë i paguaj të dhjetën dhe ofertat e agjërit.					
Unë e marr sakramentin çdo javë.					
Unë jam i/e denjë për një rekomandim tempulli.					
Unë kam një vend pune ose vetëpunësim që më siguron për nevojat e mia.					
Unë i plotësoj nevojat e mia pa u mbështetur te programet qeveritare.					
Unë e paguaj qiranë ose kredinë mujore të shtëpisë.					
Unë kam kujdes të përshtatshëm shëndetësor.					
Fëmijët e mi kanë mundësi arsimimi.					
Unë jam në gjendje t'u shërbej të tjerëve në kohën e tyre të nevojës.					

Përsiatni: A ka gjëra të tjera që keni nevojë t'i ndryshoni, që të bëheni i/e mbështetur te vetja? Si do të jetë jeta juaj kur t'i përmirësoni zërat më sipër?

SI BËHEM MË I/E MBËSHTETUR TE VETJË?

1. Zoti Mund t'ju Ndhimojë të Bëheni të Mbështetur te Vetja

Shihni: "I Will Provide for My Saints" ["Unë Do Të Siguroj për Shenjtorët e Mi"], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Vazhdoni të lexoni.)

VEPRIMTARI GRUPI (5 minuta)

Më poshtë jepet një letër e dhënë nga Presidenti Diter F. Uhtdorf në materialin filmik.

Si grup:

1. Lexojeni secilin paragraf duke e bërë me radhë.
2. Për secilin paragraf bëni sa vijon:
 - Nënvizoni bekimet e veçanta që premtohen nga Presidenca e Parë.
 - Qarkoni atë që duhet të bëni për t'i marrë ato bekime.
 - Diskutoni shkurtimisht atë që po mësoni.

Të Dashur Vëllezër dhe Motra:

Zoti ka shpallur: "Është qëllimi im për të siguruar për shenjtorët e mi" (DeB 104:15). Kjo zbulesë është një premtim nga Zoti se Ai do të sigurojë bekime materiale dhe do ta hapë derën e mbështetjes te vetja, e cila është aftësia jonë që t'i sigurojmë nevojat e jetës për veten dhe pjesëtarët e familjes sonë.

Kjo broshurë është përgatitur për t'i ndihmuar anëtarët e Kishës që t'i mësojnë dhe t'i vënë në zbatim parimet e besimit, arsimimit, të punuarit fort dhe mirëbesimit në Zot. Pranimi dhe të jetuarit e këtyre parimeve do t'ju bëjnë më të mundur që t'i merrni bekimet materiale të premtuara nga Zoti.

Ne ju ftojmë që t'i studioni me zell dhe t'i zbatoni këto parime, dhe t'ua jepni mësim pjesëtarëve të familjes suaj. Ndërsa bëni kështu, jeta juaj do të bekohet. Ju do të mësoni se si të veproni në shtegun tuaj drejt mbështetjes më të madhe te vetja. Ju do të bekoheni me shpresë, paqe dhe përparim më të madh.

Ju lutemi, jini i sigurt se ju jeni një fëmijë i Atit tonë në Qiell. Ai ju do dhe nuk do t'ju braktisë asnjëherë. Ai ju njeh dhe është gati t'ju shtrijë bekimet shpirtërore dhe materiale të mbështetjes te vetja.

Sinqerisht,

Presidenca e Parë

Përsiatni: Çfarë mund të bëj unë vetë që të marr “shpresë, paqe dhe përparim më të madh”, siç u premtua nga Presidenca e Parë?

2. Shkrimet e Shenjta Mund t’ju Ndhimjnë të Bëheni të Mbështetur te Vetja

Lexoni: Zoti na ndihmon në shumë mënyra kur ushtrojmë besim tek Ai. Njëri nga mjetet që na ka dhënë Ai, janë shkrimet e shenjta. Profeti Nefi dha mësim: “Ushqehuni me bollëk me fjalët e Krishtit; pasi, vini re, fjalët e Krishtit do t’ju tregojnë të gjitha gjërat që ju duhet të bëni” (2 Nefi 32:3).

Diskutoni: Kur ju kanë dhënë shkrimet e shenjta udhërrëfim vetjak në jetën tuaj?

VEPRIMTARI GRUPI (5–7 minuta)

Libri i Mormonit u dha si një mjet për kohën tonë. Nëse i përshtatim vargjet e Librit të Mormonit për vetë jetën tonë, ne vërtet do të marrim tërë udhërrëfimin e nevojshëm. Si grup **lexoni** dhe **diskutoni** secilën prej thënieve më poshtë nga profetët dhe apostujt. Nënvizoni bekimet e premtuara për studimin dhe zbatimin e shkrimeve të shenjta.

Henri B. Ajring: “Vajtja te shkrimet e shenjta që të mësojmë se çfarë të bëjmë, sjell të gjithë ndryshimin. . . . Vërtet do të gjejmë përgjigje në shkrimet e shenjta. Zoti dukej se i parashikoi të gjitha problemet tona e të gjitha nevojat tona dhe Ai vendosi ndihmë në shkrimet e shenjta për ne – vetëm nëse e kërkojmë atë” (“A Discussion on Scripture Study”, *Ensign*, korrik 2005, f. 24).

Bojd K. Paker: “Nuk ka asnjë problem madhor që e hasim, ndaj të cilit nuk mund të vaksinohejmë, në qoftë se i dimë zbulesat” (“Teach the Scriptures”, *Teaching Seminary Preservice Readings Religion 370, 471 dhe 475* [2004], f. 75).

Riçard G. Skot: “Libri i Mormonit mban përgjigje për problemet që i hasim në jetën e përditshme” (“The Power of the Book of Mormon in My Life”, *Ensign*, tetor 1984, f. 10).

M. Rasëll Ballard: “Libri i Mormonit, mbi të gjithë librat e tjerë që i di, është burimi më madhor që kemi për përgjigje ndaj problemeve të vërteta të jetës” (në “We Add Our Witness”, *Ensign*, mars 1989, f. 8).

Rasëll M. Nelson: “A doni të hiqni dorë nga një zakon i keq? A doni t’i përmirësoni marrëdhëniet në familjen tuaj? A doni ta rritni aftësinë tuaj shpirtërore? Lexojeni Librin e Mormonit! Ai do t’ju sjellë më pranë Zotit dhe fuqisë së Tij plot dashuri” (“A Testimony of the Book of Mormon”, *Ensign*, nëntor 1999, f. 71).

Përsiatni: Kur kërkoj të bëhem më i/e mbështetur te vetja, çfarë mund të bëj për të marrë më shumë udhërrëfim vetjak nga shkrimet e shenjta?

3. Bashkimi me një Grup të Mbështetjes te Vetja Mund t'ju Ndihmojë të Filloni

Lexoni: Për t'ju ndihmuar të bëheni më të mbështetur te vetja, ju keni mundësi të bashkoheni me një grup të mbështetjes te vetja në lagjen ose kunjin tuaj. Një grup i mbështetjes te vetja është një grup individësh që takohen së bashku për të mësuar dhe ushtruar aftësi praktike për punësim, arsimim dhe financa.

Grupet e mbështetjes te vetja zakonisht takohen çdo javë për dy orë gjatë një periudhe tremujore. Mbledhjet ndjekin të njëjtin proces si kjombledhje shpirtërore. Anëtarët e grupit lexojnë e diskutojnë së bashku, përfundojnë veprimtaritë, si edhe përsiatin në mënyrë individuale kështu që Fryma e Shenjtë të mund t'i frymëzojë se si të veprojnë.

Një grup i mbështetjes te vetja është i ndryshëm nga shumica e kurseve të Kishës. Nuk ka mësues! Përkundrazi, grupi punon si një këshill me Frymën e Shenjtë si mësuesi. Anëtarët e grupit këshillohen së bashku ndërsa mësojnë aftësi të reja, zgjidhin probleme, zotohen të bëjnë gjëra gjatë javës dhe e raportojnë përparimin e tyre.

Anëtarët e grupit gjithashtu zhvillojnë miqësi të forta dhe ndiejnë dashurinë e Perëndisë teksa punojnë së bashku. Bashkimi me një grup jo vetëm që do t'ju sjellë dobi, por ju mund të jepni një shërbim të madh për t'i ndihmuar të tjerët në shtegun e tyre drejt mbështetjes te vetja.

Shihni: "The Power of the Group" ["Fuqia e Grupit"], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Vazhdoni të lexoni.)

Ndërmjetësi: Nëse është në dispozicion, ftojeni dikë që ka marrë pjesë më parë në një grup të mbështetjes te vetja, që ta tregojë shkurtimisht (deri në tri minuta) përvojën e tij ose të saj.

Me Cilin Grup të Mbështetjes te Vetja Duhet të Bashkoheni?

Shihni: "Choosing a Self-Reliance Group" ["Zgjedhja e një Grupi të Mbështetjes te Vetja"], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni përmbledhjet e grupeve te faqja 11.)

VEPRIMTARI INDIVIDUALE (3-4 minuta)

Lexoni në mënyrë të pavarur të gjitha thëniet më poshtë dhe **qarkoni** pohimin/et që gjen/jnë zbatim për ju. Një përmbledhje e secilit grup është te faqja 11.

	Gjeni një Vend Pune më të Mirë	Financat Personale	Arsimim për Punë më të Mirë	Nisja dhe Rritja e Biz- nesit Tim
1. Më nevojiten para menjëherë.	✓			
2. Jam i papunë.	✓			
3. Kam nevojë për një vend pune më të mirë.	✓			
4. Dua të kursej para.		✓		
5. Dua ta mënjanoj borxhin.		✓		
6. Dua të jem i përgatitur financiarisht për të ardhmen.		✓		
7. Kam nevojë për arsimim ose trajnim që të gjej një vend pune më të mirë ose të filloj një karrierë të re.			✓	
8. Kam nevojë për ndihmë që të zgjedh shtegun tim të arsimimit.			✓	
9. Dua të dal me sukses në shkollë.			✓	
10. Dua të mësoj më shumë rreth arsimimit të ofruar nga Kisha, të tillë si Pathway (shih faqen 12).			✓	
11. Kam një biznes ekzistues.				✓
12. Kam burime për ta filluar një biznes.				✓
13. Mund ta mbështet veten time ndërkohë që filloj një biznes.				✓
14. Dua të rrit besimin tim te Jezu Krishti.	✓	✓	✓	✓

Lexoni: Bërja e ndryshimeve në jetën tonë kërkon besim dhe përpjekje. Që ju të përparoni, keni nevojë të zotoheni për të bërë sa vijon:


- Frekuentoni çdo javë (zakonisht 2 orë çdo javë për 3 muaj).
- Gjatë javës veproni sipas zotimeve.
- Nxitini të tjerët në grup që të dalin me sukses.
- Bëni rreth 4 deri në 10 orë pune çdo javë jashtë mbledhjeve të grupit.

Përsiatni: Cili grup i përputhet më mirë gjendjes sime? A jam i gatshëm t'i bëj këto zotime me qëllim që të bëhem më i mbështetur te vetja?

PËRMBLEDHJET E GRUPEVE

Në secilin prej katër grupeve të mbështetjes të vetja anëtarët studiojnë dhe ushtrojnë parime nga broshura *Themeli Im për Mbështetjen të Vetja*. Kjo bëhet në fillim të mbledhjes së secilit grup, pasi mësimi i këtyre parimeve dhe aftësive themelore i ndihmon anëtarët e grupit të përparojnë materialisht dhe shpirtërisht, pavarësisht nga shtegu i zgjedhur. Anëtarët e grupit do të fitojnë besim më të madh të fuqia e Jezui Krishtit për të siguruar për ta. Ata do të ushtrojnë edhe aftësi jetësore, duke përfshirë menaxhimin e kohës, komunikimin dhe zgjidhjen e problemeve.

Gjeni një Vend Pune më të Mirë



Për ata që po kërkojnë punë ose një vend pune më të mirë. Anëtarët e grupit do të mësojnë që të përcaktojnë mundësitë, të krijojnë rrjetin e bashkëpunimit, të paraqiten në mënyrë profesionale dhe të përgatiten për intervista për vende pune. Ata gjithashtu do të caktojnë synime për kontakte dhe intervista.

Financat Personale



Për ata që dëshirojnë të kontrollojnë më mirë financat e tyre. Anëtarët e grupit do të mësojnë se si ta menjanojnë borxhin, të mbrohen kundrejt vështirësive financiare dhe të investojnë për të ardhmen. Ata do të krijojnë një plan financiar dhe do të ndjekin një buxhet. Bashkëshortët nxiten që të marrin pjesë së bashku.

Arsimim për Punë më të Mirë



Për ata të cilëve u nevojitet arsimim ose trajnim shtesë që të gjejnë një vend pune. Anëtarët e grupit do të hulumtojnë, krijojnë e paraqesin plane karriere dhe arsimimi. Ata gjithashtu do të shpenzojnë kohë çdo javë duke ushtruar aftësi që do t'i ndihmojnë të jenë më të efektshëm për të mësuar.

Nisja dhe Rritja e Biznesit Tim



Për ata që e kanë tashmë një biznes ose burime për ta nisur një biznes. Anëtarët e grupit mësojnë tipare dhe aftësi të pronarëve të suksesshëm të bizneseve të vogla. Ata ushtrojnë mbajtjen e dokumenteve, reklamimin dhe administrimin e parave në dorë. Ata do të flasin me pronarë biznesesh, klientë e furnizues dhe do të zhvillojnë plane për ta rritur biznesin e tyre.

ZGJIDHNI NJË GRUP

Një anëtar i komitetit të mbështetjes te vetja tani do t'ju ndihmojë të organizoheni në grupe të mbështetjes te vetja. Pasi ta keni përzgjedhur grupin tuaj, shkruani informacionin vijues.

MBLEDHJET E GRUPIT TIM PËR MBËSHTETJEN TE VETJA

Dita:

Ora:

Vendi:

Emri i ndërmjetësit:

Numri i telefonit:

Ndërmjetësi : Autoriteti kryesues mund të dojë të japë një dëshmi të shkurtër.

Mbylleni me lutje.

MUNDËSITË ARSIMORE TË SAK-UT

Sistemi Arsime i Kishës (SAK-u) ofron mundësi arsimore me kosto të ulët që mund të çojnë te një punë më e mirë. Ato përfshijnë:

- Kurse dhe trajnime të shkurtra në internet nga Kolegji SHDM i Biznesit, të cilat ju ndihmojnë të kualifikoheni për një vend pune të caktuar, të përparoni në punësimin tuaj të tanishëm ose të merrni një certifikatë. Kurset zgjatën nga 15 minuta deri në 12 javë dhe mund të çojnë drejt një interviste të garantuar për vend pune.
- Pathway është një program njëvjeçar që ju ndihmon të përgatiteni për ta filluar kolegjin ose që të ktheheni sërish në kolegji. Studentët zhvillojnë kurse në internet dhe marrin pjesë në grumbullime vendore. Pas përfundimit, studentët mund të punojnë drejt një certifikate ose diplome në shkollat vendore, në UBJ-Ajdaho ose Kolegjin SHDM të Biznesit. Pathway kërkon njohuri mesatare të anglishtes.

Që të gjeni se çfarë është në dispozicion në zonën tuaj, vizitoni churcheducation.lds.org.

SI TË BËJMË NJË MBLEDHJE SHPIRTËRORE TË PROGRAMIT SHTEGU IM

Udhëzime për një Komitet të Kunjit për Mbështetjen te Vetja

- Përpara Mbledhjes Shpirtërore:**
- Rishikojeni dhe plotësojeni vetë këtë broshurë.
 - Porositni broshura *Shtegu Im për Mbështetjen te Vetja* në numër të mjaftueshëm për pjesëmarrësit (store.lds.org).
 - Kini sasi të mjaftueshme stilolapsash ose lapsash për pjesëmarrësit.
 - Rregulloni një numër të mjaftueshëm tavolinash rrumbullake në sallën kulturore.
 - Vendosni anëtarë të komitetit të mbështetjes te vetja te çdo derë për t'i përshëndetur ata që frekuentojnë, dhe për t'u bashkuar me pjesëmarrësit që janë te tavolinat.
 - Nëse është e mundur, ftoni dikë që ka marrë pjesë në një grup të mëparshëm, që ta tregojë përvojën e tij ose të saj në mbledhjen shpirtërore (shih faqen 9).
 - Vizitoni srs.lds.org/report për të shkarkuar Formularin e Raportimit të Mbledhjes Shpirtërore që do të plotësohet gjatë mbledhjes shpirtërore.

- Gjatë Mbledhjes Shpirtërore:**
- Vendosni një anëtar të komitetit te secila tavolinë për të nxitur pjesëmarrjen në grup dhe për t'i mbajtur gjërat brenda kohës së duhur.
 - Kujtojeni pjesëmarrësve që t'i vënë në heshtje telefonat e tyre celularë.
 - Merrni parasysh ta filloni mbledhjen shpirtërore me një këngë, lutje dhe një mirëseardhje të shkurtër (3–5 minuta) nga një udhëheqës priftërie ose një anëtar i komitetit të kunjit për mbështetjen te vetja.
 - Ndiheni materialin siç shkruhet në broshurë.
 - Bëjeni ndërmjetësin e secilit grup të shkruajë emrin dhe numrin e telefonit për secilin person që është pjesë e grupit të vet. Në mbledhjen e parë të grupit, çdo ndërmjetës do të plotësojë një formular regjistrimi më të hollësishëm të grupit.
 - Nëse kunji shtrihet në një zonë të madhe gjeografike, komiteti i kunjit mund ta marrë parasysh ndarjen e grupeve sipas vendit ku ndodhen anëtarët e grupit.

- Pas Mbledhjes Shpirtërore:**
- Vizitoni srs.lds.org/report për të shkruar informacionin nga Formulari i Raportimit të Mbledhjes Shpirtërore.

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

Shërbime për
Mbështetjen te Vetja
FONDI I QARKULLUESHËM ARSIMOR

